



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, datë _____ 2022

RAPORT

“MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE TË INSTITUTIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE PËR 12-MUJORIN E DYTË TË VITIT 2021”

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore është institucion kombëtar i specializuar shkencor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, ent publik me statusin e personit juridik që financohet nga buxheti i shtetit.

Detyra themelore e IKTK-së, është ruajtja, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe vlerësimi i monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë. IKTK ndërton të gjithë punën kërkimore-shkencore, ndjek zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore, kryen, mbikëqyr dhe kolaudon veprime konkrete mbi monumentet e paluajtshme dhe objektet e luajtshme, pjesë integrale e tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, bën kualifikimin e kuadrit, autorizon, si dhe përcakton kriteret e restaurimit.

Misioni i IKTK-së përfshin gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore material, në përputhje me Ligjin Nr.27/2018, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë dhe Muzetë” dhe VKM Nr. 364 datë 29.05.2019 për “*Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore*”.

Misioni i IKTK-së është të marr të gjitha masat që të siguroj gjurmimin, evidentimin, mbrojtjen, dokumentimin e plotë, konservimin, restaurimin shkencor dhe promovimin e monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore. IKTK, aktivitetin e tij e kryen në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, të cilat bazuar në Ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" vepron nën koordinimin dhe mbikëqyrjen e tij.

IKTK-ja është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Tiranë dhe financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

➤ *IKTK-ja vepron në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në fushat e përgjegjësisë, si më poshtë vijon:*

- a) të trashëgimisë kulturore materiale;
- b) të arkeologjisë parandaluese të shpëtimit nëntokësor dhe nënujor;
- c) të pasurisë e peizazhit kulturor.

➤ *IKTK-ja ka përgjegjësi të organizojë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësi në fushën:*

- a) e trashëgimisë kulturore materiale në lidhje me gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale;
- b) e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.

➤ *IKTK-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:*

- a) monitoron dhe koordinon DRTK-të, si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e tyre;
- b) konstaton verifikimin ose jo, të interesit kulturor për pasuritë e paluajtshme sipas procedurave përkatëse në ligjin për trashëgiminë kulturore;
- c) nëpërmjet sekretarisë teknike kryen verifikimet e natyrës teknike dhe siguron nga kërkuesit informacione të tjera shtesë në funksion të vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, lidhur me kërkesat për ndërhyrje;
- ç) vendos pezullimin e menjëhershëm të ndërhyrjeve kur me propozim të institucioneve të specializuara ose kryesisht konstaton kryerjen e punimeve në kundërshtim me ligjin;
- d) monitoron ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve të licencuara;
- dh) kryen formimin e vazhdueshëm të personave të pajisur me licenca në fushën e projektimit e të zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore materiale, veprimtarisë arkeologjike;
- e) kryen studime për shtrirjen e zonës së mbrojtur për pasuritë kulturore të paluajtshme ose grupimin e pasurive kulturore të paluajtshme;
- ë) vendos masat e mbrojtjes indirekte, sipas procedurës së parashikuar në ligj;
- f) propozon procedurën për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike;
- g) koordinon planet e zhvillimit, të projekteve restauruese dhe konservuese, projekteve kërkimore-shkencore të NJAKPA-ve;
- gj) ndjek gjetjet rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore ose punimeve të tjera të çfarëdollojshme dhe merr masa për shpëtimin e këtyre vlerave, sipas procedurës së parashikuar në ligj;
- h) nëpërmjet punonjësit të autorizuar pezullon punimet që mund të dëmtojnë vlerat arkeologjike deri në marrjen e një vendimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në rastin e zbulimeve të rëndësishme;
- i) regjistron njoftimet për gjetjet rastësore detare dhe nëntokësore;
- j) studion dhe përcakton kufijtë e zonave të mbrojtura të pasurive kulturore;
- k) konsulton ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidhur me hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rijetëzim për vlerat kulturore të paluajtshme;
- l) së bashku me IKRTK-në harton masat për ruajtjen, mbrojtjen, mirëmbajtjen, administrimin, tjetërsimin dhe qarkullimin e objekteve muzeore dhe të koleksioneve muzeore;

ll) kryesisht ose me propozim të institucioneve të specializuara të njësive të qeverisjes qendrore ose të vetëqeverisjes vendore fillon procedurën e vlerësimit, duke verifikuar ekzistencën e interesit të veçantë publik për pasuritë e peizazhit kulturor për pasuritë e paluajtshme dhe për zonat për të cilat është marrë iniciativa;

m) lëshon lejet e peizazhit kulturor pas miratimit të kërkesës nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, si dhe i sugjeron Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale vendosjen e distancave, masave/hapësirave dhe variante të projektit në fazë ekzekutimi të nevojshme për ruajtjen e vlerave të peizazhit;

n) përgatit dhe realizon në mënyrë periodike botime të ndryshme shkencore, albume dhe udhërrëfyes;

nj) nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim formon dhe përditëson njohuritë e restauratorëve dhe të subjekteve të licencuara;

o) nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim harton dhe zbaton programe të kualifikimit të specialistëve në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;

p) çdo detyrë tjetër të përcaktuar me ligj.

➤ *Pranë KKTKM-së funksionojnë këto struktura administrative:*

a) Këshilli teknik;

b) Sporteli unik;

c) Sekretaria teknike.

a) Këshilli teknik është organ kolegjal seleksionues, vlerësues e vendimmarrës, që ka në përbërje 7 anëtarë, të cilët janë pjesë e 15 anëtarëve të KKTKM-së. Këshilli teknik kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe vepron si trupë shqyrtuese dhe seleksionuese e përputhshmërisë së kërkesave të paraqitura pranë KKTKM-së. Vendimi ose relacioni që i dërgohet KKTKM-së nga ana e Këshillit teknik firmoset nga kryetari.

b) Sporteli unik është pjesë e strukturës administrative pranë IKTK-së, ku depozitohen të gjitha kërkesat për aplikim, për të cilat është kompetente KKTKM-ja. Detyrat, funksionet dhe mënyra e ushtrimit të tyre përcaktohen në rregulloren për veprimtarinë e KKTKM-së.

c) Sekretaria teknike është pjesë e strukturës administrative të IKTK-së, në funksion të KKTKM-së, e cila administron kërkesat dhe përgatit dokumentacionin për vendimmarrje të KKTKM-së. Detyrat, funksionet dhe mënyra e ushtrimit të tyre përcaktohen në rregulloren për veprimtarinë e KKTKM-së.

OBJEKTIVAT

1. Të përditësojë kuadrin ligjor për mbrojtjen, konservimin, restaurimin dhe rijetëzimin e pasurive kulturore në territorin e Shqipërisë, me qëllim përmirësimin e tij, në përputhje me legjislacionin e sektorëve të tjerë në Shqipëri, si dhe t'a përafrojë me atë të BE-së;

2. Të krijojë dhe forcojë partneritete, marrëveshje apo protokolle bashkëpunimi me palë të ndryshme interesi në funksion të përmbushjes së misionit të tij;

3. Të krijojë dhe përditësojë bazën e të dhënave mbi pasuritë kulturore dhe listën kombëtare të monumenteve të kulturës dhe zonave të trashëgimisë kulturore;
4. Të propozojë vënien në mbrojtje të shtetit të objekteve, grupeve të objekteve dhe zonave nëpërmjet deklarimit të tyre pasuri kulturore në bazë të studime të thelluara kërkimore -shkencore;
5. Të kontrollojë gjendjen e konservimit të monumenteve dhe të ndjekë zbatimin e legjislacionit në fushën e monumenteve të kulturës, nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK);
6. Të hartojë dhe ndjekë zbatimin e kriterëve për ruajtjen, konservimin, restaurimin dhe rijetëzimin e objekteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore;
7. Të zbatojë detyrimet që lidhen me Konventën e Trashëgimisë Botërore lidhur me mbrojtjen dhe menaxhimin e siteve kulturore apo mikse me status Pasuri Botërore në Shqipëri;
8. Të marrë të gjitha masat në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përgatitjen, planifikimin dhe përballimin e fatkeqësive natyrore dhe njerëzore;
9. Të hartojë projekte mbi ndërhyrjet në pasuritë kulturore si dhe kontrollojë zbatimin e tyre nga Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, apo nga subjekte të licencuar sipas dispozitave ligjore në fuqi;
10. Të planifikojë, drejtojë apo mbikëqyrë nga ana shkencore punimet konservuese dhe restauruese të pasurive kulturore;
11. Të sigurojë hartimin sipas kriterëve të caktuara dhe dorëzimin në arkivën teknike të dokumentacionit të rregullt për të gjitha studimet dhe ndërhyrjet që kryhen mbi pasuritë kulturore;
12. Në bashkëpunim me organet e njësive vendore, të studiojë kërkesat për ndërtime të reja në zonat e mbrojtura dhe të argumentojë pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) mbi miratimin ose jo të tyre;
13. Të ushtrojë veprimtarinë në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si dhe të sigurojë mbarëvajtjen e proceseve arkeologjike si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.
14. Të ndjekë gjetjet rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore ose punimeve të tjera të çfarëdollojshme dhe të marrë masa për shpëtimin e këtyre vlerave, sipas procedurës së parashikuar në ligj.
15. Të mbikëqyrë proceset arkeologjike në terren e të ecurisë së punimeve të gërmimit gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore, në varësi të vendimeve të organeve vendimmarrëse kolegjiale.
16. Të koordinojë mbikëqyrjen e subjekteve private të licencuara gjatë kryerjes së proceseve arkeologjike të shpëtimit, në zbatim të vendimeve të KKTKM.
17. Të hartojë dhe zbatojë programe për forcimin e kapaciteteve profesionale në fushën e konservimit të trashëgimisë kulturore materiale, nën koordinimin e UNESCO-s, nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim të Evropës Juglindore;
18. Të inkurajojë forcimin e kapaciteteve profesionale të stafëve të sistemit të trashëgimisë kulturore përmes kualifikimit dhe formimit të vazhdueshëm;
19. Të krijojë dhe ndjekë një plan strategjik komunikimi me qëllim promovimin e punës, njohjen e publikut me trashëgiminë kulturore, evidentimin dhe sensibilizimin e publikut në lidhje me të gjitha çështjet të cilat prekin trashëgiminë kulturore materiale;
20. Të sigurojë vazhdimësinë e botimit të revistës periodike “Monumentet” organ i IKTK-së, si dhe të realizojë dhe mbështesë botime mbi fushën e trashëgimisë kulturore.

BUXHETI I IKTK-së

IKTK është pjesë e Programit të Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë të Programit 08220, pjesë e Ministrisë së Kulturës.

Programi financiar 2021 synon në ruajtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore nëpërmjet konservimit, restaurimit dhe rehabilitimit të objekteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale, nisur nga emergjenca për të ndërhyrë në objekte me rëndësi të veçantë për kulturën kombëtare që rrezikojnë të humbasin vlerat e tyre të rralla, për të cilat identifikohemi si një ndër popujt më të vjetër të Ballkanit dhe në zhvillimin e Turizmit Kulturor në përgjithësi.

Realizimi dhe monitorimi i shpenzimeve të tij, për 12-mujori i vitit 2021 është bazuar në zbatim të Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) kreu 8, neni “Monitorimet”, Udhëzimit Nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”.

Ky vit, ashtu si dhe në gjithë botën, Shqipëria vazhdon të përballet me pandeminë globale e shkaktuar nga virusi Covid 19.

Puna institucionale gjatë këtij viti është zhvilluar në përputhje me masat ligjore kundër përhapjes së pandemisë, duke përfshirë pjesërisht punën me rotacion në zyrë, duke bërë të pashmangshme telepunën në kushte online.

Me Vendim Nr. 213, datë 11.3.2020 “Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si Njësi Zbatuese, dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore”, IKTK-ja u caktua si *njësi zbatuese* për administrimin e fondit në vlerën **236 627 069** (dyqind e tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind enjëzet e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për restaurimin/rindërtimin e pasurive kulturore në njësitë territoriale të bashkive Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Rrogozhinë e Vorë.

Në zbatim të VKM-së nr. 213, datë 11.03.2020 “*Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si njësi zbatuese, dhe për përdorimin e e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore*”, në pikën 3 të të cilit citohet: - **“Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara, pas përfundimit të procedurave në zbatim të këtij vendimi, kthehen në buxhetin e fondit për rindërtimin dhe trashëgohen në vitin pasardhës”,** fondet pashpenzuara në mbyllje të vitit 2020 janë transferuar për vitin 2021.

Për 12-mujorin e vitit 2021, niveli i realizimit të buxhetit në vlerë totale për Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore është 103,194 mijë lekë, dhe në përqindje realizimi është në nivelin 85.3% të planit buxhetor. Në tregues analitik, plani dhe realizimi sipas artikujve buxhetor paraqitet në formë tabelare si më poshtë:


**TË DHËNAT BUXHETORE PLANI – FAKTI SIPAS ZËRAVE TË ARTIKUJVE PËR
PERIUDHËN
JANAR – DHJETOR 2021, PËR IKTK**

Nr	Kodi PROJEKT	Përshkrimi	ART	Plan Vjetor 2021	Realizimi Vjetor 2021	Realizimi ne %
1	91202AA	Paga	600	44,791	43,138	96.31
2	91202AA	Sigurime Shoqërore dhe Shëndetsore	601	7,450	7,228	97.02
3	91202AA	Shpenz. Operative	602	16,556	15,375	92.87
4	91202AA	Transferta korente te Huaja /Anetaresime	605	241	25	10.37
5	91202AA	Transferta per Bux.Fam.&Individ	606	276	268	97.1
6	19AD706	Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruse në objektin: "2 (dy) objekte banimi brenda Kalasë së Krujës, brenda Zonës Arkeologjike "A" të qytetit të Krujës vlerësuar me nivel dëmi DS4 (Nr. 54 dhe Nr. 66)"	230	1,861	1,800	96.72
7	19AD707	Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruse në objektin: Muri i Kalasë Durrës (pa kullën C por me Kullën Veneciane Durrës)"	230	8,001	7,800	97.49
8	19AD708	Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruse në objektin: Kalaja e Prezës (duke përfshirë Xhamia në Kalanë e Prezës, duke përfshirë kullën e Sahatit dhe murin Verilindor i kalasë)	230	22,400	22,000	98.21
9	19AD803	Kryerja e Monitorimit Arkeologjik në 26 zonat e reja të Zhvillimit	230	13,522	0	-
10	18CF309	Paraфинancim për projektin IPA "MoNa", "Realizimi i punimeve të konservimit dhe drenazhimit në Portës me kulla dhe Nimfeu, qyteti antik Butrint"	231	1,376	1,376	100
11	18AE221	Restuarim "Kisha e Shën e Premtes" Lukove.	231	3,610	3,606	99.89
12	18CF314	Projekti IPA "3C-IKTK".	231	254		-
13	18CF309	Projekti Mona	231	591	578	97.8
		Total		120,929	103,194	85.33


- **Zëri i shpenzimit "Paga"** për vitin 2021 është realizuar në masën 96.31 %, në raport me planin e parashikuar në vlerë 44.791 mijë lekë. Kjo diferencë është krijuar përgjatë vitit 2021, ka patur mungesa të justifikuara dhe lëvizje të stafit (largime).
- **Zëri i shpenzimit "Sigurime Shoqërore dhe Shëndetsore"** për vitin 2021 është realizuar në masën 97,02 %. Ky zë i shpenzimit në buxhet është i lidhur me zërin e shpenzimit "Paga" për të cilin argumentimi është i njëjtë.
- **Zëri i shpenzimit "Shpenzime Operative"** për vitin 2021 është realizuar në masën 92.87 %. Ky zë i shpenzimit në buxhet është përdorur për realizimin e kërkesave dhe nevojave të Institucionit tonë për blerje mallra dhe shërbime. Teprica e fondit është përftuar si rezultat i vlerave limit të prokurimeve në raport me ofertat ekonomike më të ulta të paraqitura nga operatorët fitues.

- **Zëri i shpenzimit " Transferta korente te Huaja /Anetaresime "** për vitin 2021 është realizuar në masën 10.37 %. Ky zë i shpenzimit në buxhetin e Institucionit tonë ka një nivel realizimi të ulët. Ky zë i shpenzimeve është i lidhur ngushtësisht me situatën e pandemisë Covid 19, nga e cila, mundësia e pjesmarrjes në aktivitetet/konferenca ishte e pamundur dhe zhvillimi on-line i tyre bri që niveli i kërkesave për pagesa të kuatave të pjesmarrjes të jetë i ulët.
- **Zëri i shpenzimit " Transferta për Bux.Fam.&Individ "** për vitin 2021 është realizuar në masën 97.1 %. Ky zë i shpenzimit në buxhet është përdorur për realizimin e shpërblimit në rast fatkeqësie si dhe pagesën e shpenzimeve të telefonisë celulare për titullarin e Institucionit.
- **Zëri i investimit " Hartim Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruse në objektin: "2 (dy) objekte banimi brenda Kalasë së Krujës, brenda Zonës Arkeologjike "A" të qytetit të Krujës vlerësuar me nivel dëmi DS4 (Nr. 54 dhe Nr. 66)"** për vitin 2021 është realizuar në masën 96.7 %. Teprica vjen si rezultat i procedurës së prokurimit, si diferencë e fondit limit të planifikuar kundrejt ofertës të kontraktuar.
- **Zëri i investimit " Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruse në objektin: Muri i Kalasë Durrës (pa kullën C por me Kullën Veneciane Durrës)"** për vitin 2021 është realizuar në masën 97.49 %. Teprica vjen si rezultat i procedurës së prokurimit, si diferencë e fondit limit të planifikuar kundrejt ofertës të kontraktuar.
- **Zëri i investimit " Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruse në objektin: Kalaja e Prezës (duke përfshirë Xhamia në Kalanë e Prezës, duke përfshirë kullën e Sahatit dhe murin Verilindor i kalasë)"** për vitin 2021 është realizuar në masën 98.21 %. Teprica vjen si rezultat i procedurës së prokurimit, si diferencë e fondit limit të planifikuar kundrejt ofertës të kontraktuar.
- **Zëri i investimit "Kryerja e Monitorimit Arkeologjik në 26 zonat e reja të Zhvillimit"** për vitin 2021 nuk është realizuar. Në lidhje me këto monitorime arkeologjik për zonat e rindërtimit të miratuar me vendim Nr. 453, datë 03.12.2020 dhe Nr. 454, datë 03.12.2020 të KKTKM, procesi nuk është realizuar, pasi njësitë zbatuese nuk kanë njoftuar mbi fillimin e punimeve dhe kërkesën për lidhjen e kontratës së monitorimit arkeologjik. Njësi zbatuese janë: Bashkia Durrës dhe Bashkia Lezhë. Në këto kushte, procesi i prokurimit të fondit në vlerë 13.521.750 lekë pa tvsh, për "Kryerjen e Monitorimit Arkeologjik në 26 zonat e reja të Zhvillimit", nuk ka filluar akoma. IKTK ka realizuar verifikimin në terren dhe relevimin e zonave për të nxitur zbatimin e këtij investimi. Mbi këtë bazë, ka kërkuar transferuarimin e fondit në të njëjtat kode ekonomike, për buxhetin e vitit 2022.
- **Zëri i investimit "Parafinancim për projektin IPA "MoNa", "Realizimi i punimeve të konservimit dhe drenazhimit në Portës me kulla dhe Nimfeu, qyteti antik Butrint"** për vitin 2021 është realizuar në masën 100 %.
- **Zëri i investimit "Restuarim "Kisha e Shën e Premtes "Lukove",** për vitin 2021 është realizuar në masën 99.89 %. Teprica vjen si rezultat i procedurës së prokurimit, si diferencë e fondit limit të planifikuar kundrejt ofertës të kontraktuar.
- **Zëri i investimit Projekti IPA "3C-IKTK"** për vitin 2021 nuk është realizuar . Ky mosrealizim ka ardhur si rezultat i statusit të furnitorit, i cili nuk është subjekt i TVSH-së.
- **Zëri i investimit " Projekti Mona "** për vitin 2021 është realizuar në masën 97.8 %. Teprica vjen si rezultat i procedurës së prokurimit, si diferencë e fondit limit të planifikuar kundrejt ofertës së kontraktuar .

Grafikisht niveli i realizimit të Buxhetit 2021, sipas artikujve buxhetore paraqitet:



Grafiku i realizimit të Investimeve (230) paraqitet në masën 68% të realizimit:



Grafiku i realizimit të Projekteve (231) paraqitet në masën 97.8% të realizimit:



PRODUKTET PER IKTK JANË:

Nr	Emërtimi	Struktura përgjegjëse	Produkti	Parashikimi Janar-Dhjetor 2021	Realizimi Janar – Dhjetor 2021
1	Hartim projekti	IKTK	Projekte te Hartuar.	62	43
2	Relacionet përmbledhëse për çdo aplikim të depozituar pranë IKTK-së. Prezantime në kuadër të mbledhjeve të organizuara për Këshillin Teknik dhe Këshillin Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.	IKTK	Relacion Projekti.	400	706
3	Shqyrtim i aplikimeve për pajisje me licenca individuale për person fizik/juridik për ndërhyrje në pasuritë kulturore materiale dhe veprimatrinë arkeologjike.	IKTK	Person Fizik/Juridik të licencuar.		218
4	Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të restaurimit	DMK	Projekte të Restauruara.	21	45
5	Shqyrtim dhe Vërtetim në lidhje me kërkesat e individëve apo subjekteve mbi statusin e pasurive kulturore materiale.	IKTK	Vërtetime mbi statusin e pasurive.		33
6	Akte nënligjore të shlytuara apo hartuara në bashkëpunim me MK dhe të tjerë.	IKTK	Akte ligjore të shqyrtuara.	30	31
7	Hartimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë.	IKTK	Marrëveshje.	1	1
8	Rikualifikim Urban Qender Historike dhe Ansambel Urban	Spektori i Qendrave Historike, Arkitektures se Tradites dhe Peizazhit	Rikualifikim Urban Qendër Historike dhe Ansambël Urban.	5	3
9	Asistencë me konsulence teknike apo administrative me palë të treta.	Spektori i Qendrave Historike, Arkitektures se Tradites dhe Peizazhit +Spektori Antiko Mesjetar	Asistencë me konsulencë teknike apo administrative me palë të treta.	7	13
10	Verifikim interesi kulturor	Spektori i Arkitekturës Antike dhe Mesjetare	Verifikim interesi kulturor.	11	0
11	Rindërtim dhe hedhje e të dhënave tek Faqja Zyrtare të IKTK-së	IKTK	Faqe Website.	1	1
12	Shërbim Arkivi Teknike (kërkesa nga Institucionet e Trashëgimisë dhe të tjerë)	IKTK	Shërbimi sipas Aplikimeve.	150	200
13	Arkivim pranë Arkivit Teknik i dosjeve të projekteve	IKTK	Dosje të arkivuara.	260	144
14	Arkivim pranë Arkivit Teknik i dosje supervizime/ kolaudime.	IKTK	Dosje të arkivuara.	10	20
15	Skanim i dosjeve per procesin e Digjitalizimit të Arkivit Teknik.	IKTK	Dosje të skanuara.	220 0	558
16	Trajtim i pikturave murale, mozaikëve dhe objekteve prej druri.	Spektori i veprave të artit	Piktura Murale të trajtuara.	10	7
17	Përgatitja e Tabelave informuese.	Spektori i veprave të artit	Tabela informative të plotësuar.	6	6
18	Botimi i Aktivitetve të IKTK për DMK dhe DSHA	IKTK	Botime.	1	1
19	UNESCO/Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të Komitetit të Trashëgimisë Botërore për 3 (tre) pronat Pasuri Botërore.	SQRKREJL	Raport i miratuar për gjëndjen e Konservimit për Trashëgiminë Kulturore.	3	3
20	Menaxhim / zbatim i projekteve me fonde të Unesco, Plani i menaxhimit Berat Gjirokaster	IKTK	Plan i hartuar.		4
21	Menaxhim / zbatim i projekteve me fonde të Unesco, I Digjitalizimit te Arkives Teknike te IKTK-se.	IKTK	Arkivë e digjitalizuar.		4
22	Verifikim në terren	SSHANN	Verifikim në terren	30	14
23	Vëzhgim arkeologjik	SSHANN	Vëzhgim arkeologjik	4	0
24	Sondazhe dhe gërmime arkeologjike/ dokumentime	SSHANN	Sondazhe të kryera	5	3
25	Ndjekje e gjetjeve rastësore	SSHANN	Ndjekje rastësore.	10	5
26	Mbikëqyrje arkeologjike në terren	SMVANN	Mbikëqyrje arkeologjike.	18	19
27	Konferenca EAC- European Archaeological Council	DSHA	Përfaqësim në Konferencë.	1	0

28	Konferenca EAA - European Association of Archaeologists	DSHA	Përfaqësim në Konferencë.	1	0
29	Rregjistrim i dokumentacionit, të marrë nga aplikimet nëpërmjet sistemit on-line i detajuar edhe sipas aplikanteve, shoqëri/individ të licensuar në arkeologji	Spektori i Platformes Digjitale të Trashëgimisë Kulturore	Projekte Zhvillimi, të aplikuar dhe regjistruar në Sistemin WebGIS.	120	180
30	Përditësimi i të dhënave "Sistemi për Inventarizimin dhe hartëzimin e Monumenteve të Kulturës në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet hartës GIS" si dhe WEBGIS I ASHA	DMK	Webgis i përditësuar		2
31	Pjesëmarrje e 2 punonjësve në Trajnim ndërkombëtar për Planifikimin interpretativ në sitet e trashëgimisë botërore	DMK	Staf i trajnuar		1
32	Pjesëmarrje në trajnim "Elementet e fotografisë"	DMK	Staf i trajnuar		2
33	"Takimi i përbashkët prezantues organizuar nga ICUA", në 17-18 qershor 2021.	DSHA	Përfaqësim i Institucionit në aktivitete ndërkombëtare		1
34	Simpoziumin ndërkombëtar Mo.Na, organizuar nga Qendra Evropiane për Monumentet Bizantine dhe Pasbizantine në Selanik/Greqi, në datat 7-9 korrik 2021	DMK	Përfaqësim i institucionit në aktivitete ndërkombëtare.		1
35	Takimi i Komisioneve Kombëtare për zonën pasuri botërore të Liqenit të Ohrit, i cili u organizua në Ohër, Maqedonia e Veriut, më datën 12.07.2021.	IKTK	Përfaqësim i Institucionit në aktivitete ndërkombëtare.		
36	Kursi i Bazave të Arkeologjisë Nën ujë 2021" organizuar nga ICUA", i cili u zhvillua më datat 30 Gusht-10 Shtator 2021, në Zadar, Kroaci. Trajnim	DSHA	Staf i trajnuar		1
37	Kursi i trajnimit Planifikimi Interpretues i Pasurive të Trashëgimisë Botërore në Evropë - EH-Interp", organizuar nga UNESCO, datë 11-15 tetor 2021 në Kotor, Mal i Zi.	IKTK	Staf i trajnuar		1
38	Workshopi me temë "Late Antique Villae in the Balkans (3rd-7th c.AD) në Lille- France, më datat 10-12 Nëntor,2021.	DSHA	Përfaqësim i Institucionit në aktivitete ndërkombëtare.		1
39	Punimet e Asamblesë së Përgjithshme të shteteve palë në Konventën e UNESCO-s për Trashëgiminë Botërore, që u zhvilluan në datat 24-26.11.2021, në Paris-Francë.	IKTK	Përfaqësim i Institucionit në aktivitete ndërkombëtare.		1
40	Akt-marrëveshje të lidhura në kuadër të Monitorimit Arkeologjik nga IKTK	DSHA	Marrëveshje të lidhura		22
41	Menaxhim / zbatim i projekteve me fonde të BE-së	SQRKREJL	Projekte IPA	2	2
	TOTALI			3,377	2,297

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Rudina Zoto

Konceptoi: Ada Shahkolli

Miratoi: Afrida Domnori